

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ IN PRINT PROMOTION” SHPK

Sot me date 26.02.2025, ortak i vetem themelues,

Pjerin Kolë RRABOSHTA, lindur me **23.03.1987**, ne Shkoder dhe banues ne Shkoder, madhor me zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin **Nr.BD8525712** dhe numer personal **I70323119R**,

të cilit me cilesine e ortakut themelues, me vullnet të lire e të plote dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare “, ne ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, ne Ligjin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, **“In Print Promotion” SHPK**

KREU 1

Neni 1

Krijimi

Shoqeria **“In Print Promotion ” SHPK**, është person juridik i të drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **“In Print Promotion” SHPK**, është nje shoqeri, që themelohet nga nje ortak i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqerise eshte Rr. Kole Prela, nr 24, nr pasurie 15/658 zk 8593, Shkoder. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Neni 4

Objekti i veprimtarise :

Tregtia, prodhimi dhe ofrimi i shërbimeve në fushën e promovimit, duke përfshirë dizajnin grafik, shtypjen e materialeve promocionale si fletëpalosje, broshura, katalogë, revista, kartëvizita, postera, banderola dhe reklama vizuale. Reklama dhe branding për biznese, përfshirë krijimin dhe menaxhimin e fushatave të marketingut në media sociale, platforma dixhitale dhe mediat tradicionale. Shtypje dhe personalizim i produkteve promocionale si bluza, çanta, stilolapsa dhe aksesore të ndryshëm. Ofrimi i shërbimeve të reklamimit, publicitetit dhe organizimit të fushatave promocionale për kompani dhe individë. Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të printimit dhe pajisjeve të lidhura me industrinë e reklamimit.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të papercaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.00 lekë dhe është teresisht kapital financiar nënshkruar dhe shlyer teresisht në të holla nga ortakët e shoqërisë perkatesisht:

PJERIN RRABOSHTA me 1 kuotë,

Me vendim të Asamblesë së ortakëve kapitali mund të rritet sipas formave të parashikuara nga ligji. Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë perkundrejt të tremeve, deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakeve është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e ortakeve, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortaku që përfaqëson të paktën tre të katërtat e pjesëve të kapitalit themeltar. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 5 vjeçare , emërohet z. **PJERIN RRABOSHTA**, lindur me 23.03.1987, në Shkoder dhe banues në Shkoder, madhor me

zotesi te plote per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin **Nr.BD8525712** dhe numer personal **I70323119R**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Padi të, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratorit ose ortakëve që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdoq formë qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jehet :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të metejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga menyrat e parashikuara nga ligji “Për Falimentimin e Shoqërive Tregtare”
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon menyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në

cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi, statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare **“IN PRINT PROMOTION“ shpk**, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale, autenticiteti i të cilave vertetohet nga une Noterja.

ORTAKU

Pjerin RRABOSHTA